



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

V E N D I M

Nr. 04 datë 13.01.2022

**“ PËR MIRATIMIN E BUXHETIT VJETOR TË KESHILLIT BASHKIAK
DIBËR PËR VITIN 2022 DHE PLANIN E AKTIVITETEVE ”**

Këshilli Bashkiak Dibër në mbledhjen e tij të datës 13.01.2022 me propozim të Kryetarit të Bashkisë Dibër, në mbështetje të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, në nenin 9 pika 1.3 shkronja “c”, 18, 34, 40, 41, 54, shkronja “dh”, 55 pika 3, kreu III, nenet 10-20, kreu IV, nenet 22-29, keu VII, nenet 39-41 të ligjit nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhmin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, ligjit nr.45/2019 “Për mbrojtjen civile” dhe ligjit nr.15 datë 25.11.2021 “Për buxhetin e vitit 2022” ku dërgohet detajimi i fondeve për transfertën e pakushtëzuar të përgjithshme dhe transfertën e pakushtëzuar sektoriale për vitin 2022: Këshilli Bashkiak vendosi me datë **13.01.2022** unanimisht **0** vota kundër **0** vota apstenim.

Vendosi :

1. Miratimin e buxhetit vjetor të Këshillit të Bashkisë Dibër për vitin 2022 Planin e aktiviteteve të konsultimeve .
2. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Ekonomike (Sektori i Financës) pranë Bashkisë Dibër dhe sekretariati i Këshillit .
3. Vendimi u shpall sot me date **13.01.2022**

